

RAPORT MONITORIMI I POLITIKËS

Parandalimi i
Braktisjes së
Shkollës në
Arsimin Para-
Universitar

Komuna e Obiliqit

Autore: Albanota Hyseni

Rishikues: KYC Kosova

Dizajni: Sh.P.K. "SUKI"

"Social Urban Innovation Kosova"

Të drejtat e autorit © 2025. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

Parandalimi i Braktisjes së Shkollës në Arsimin Para-Universitar

Rasti Shembull - Komuna e Obiliqit



Ky raport u realizua me mbështetjen financiare të Unicef Kosovo Programme, IOM Kosovo dhe Peacebuilding Fund, si produkt i iniciativës së implementuar nga KYC Kosova dhe Këshilli i Nxënësve të Obiliqit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk shprehin medoemos qëndrimet e autorëve/rishikuesve, KYC-it apo të donatorëve.

Hyrje

Braktisja e shkollës mbetet një sfidë e rëndësishme për Komunën e Obiliqit, duke ndikuar në arsimimin dhe të ardhmen e shumë fëmijëve, veçanërisht atyre nga komunitetet më të cënueshme. Ky fenomen është rezultat i një kombinimi faktorësh, përfshirë kushtet socio-ekonomike, mungesën e mbështetjes institucionale dhe sfidat e tjera që ndikojnë në vazhdimësinë e arsimit.

Ky dokument do të trajtojë me fokus të veçantë braktisjen e shkollës nga komunitetet jo-shumicë, përkatësisht komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët përbejnë rreth 9% të popullsisë së Obiliqit. Në Komunën e Obiliqit ekzistojnë 15 shkolla fillore, duke përfshirë edhe paralelet e ndara, si dhe 4 shkolla që punojnë me sistemin serb. Zonat ku komunitetet jo-shumicë janë të përqendruara më së shumti janë Plemetin, Palaj, Obiliq, Babimoc dhe Milloshevë. Të dhënat tregojnë se këto grupe ballafaqohen me sfida specifike që ndikojnë në qasjen e tyre ndaj arsimit dhe rrisin rrezikun e largimit të hershëm nga shkolla.

Për të adresuar këtë çështje, janë analizuar masat e ndërmarra nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) për parandalimin dhe reduktimin e braktisjes së shkollës, si dhe sfidat ekzistuese në zbatimin e politikave arsimore për komunitetet jo-shumicë. Duke identifikuar dobësitë dhe mundësitë për përmirësim, ky studim synon të ofrojë rekomandime konkrete për forcimin e mekanizmave ekzistues dhe krijimin e strategjive më efikase për parandalimin e largimit të hershëm nga arsimi në Komunën e Obiliqit.

Metodologjia

Të dhënat e raportit mbi parandalimin e braktisjes së shkollës janë mbështetur në dy aspekte:

- Analizë e kornizës ligjore dhe dokumenteve ekzistuese
- Analizë e situatës në terren

Kombinimi i analizës së dokumenteve dhe vëzhgimit të praktikës në terren ka mundësuar identifikimin e sfidave kryesore dhe formulimin e rekomandimeve për përmirësim.

Analizë e ligjeve dhe politikave ekzistuese

Sipas Nenit 22 të Kushtetutës, standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut kanë të njëjtën fuqi si ligji vendor, dhe në rast të ndonjë konflikti, ato mbizotërojnë ndaj legjislacionit të brendshëm.* Kjo dispozitë përfshin konventat kyçe që sigurojnë të drejtën për arsim dhe detyrimin e palëve nënshkruese për të ofruar arsim gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët.

Në bazë të Nenit 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar, Ministria ka për detyrë të promovojë mbrojtjen e grupeve të ndjeshme në sistemin arsimor, të garantojë sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve dhe stafit, si dhe të ndërmarrë masa për të parandaluar braktisjen e shkollës.

Për të adresuar braktisjen e shkollës, MASHT-i ka miratuar politika dhe legjislacion për të krijuar Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit (EPRBM) në nivele të ndryshme – shkollor, komunal dhe qendror. Këto ekipe u krijuan fillimisht në vitin 2012 dhe u forcua funksionimi i tyre përmes Udhëzimit Administrativ 08/2018. Ekipi në nivel shkolle përfshin pesë anëtarë nga drejtoria, mësuesit, prindërit, nxënësit dhe ekspertët përkatës. Ky ekip ka për detyrë të raportojë çdo tre muaj tek grupi i vet dhe çdo gjashtë muaj tek Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA).*

Në Komunën e Obiliqit, EPRBM-të janë themeluar në të gjitha shkollat, por shpesh nuk përfshijnë të gjithë anëtarët e paraparë, duke përjashtuar këshillin e nxënësve. Për më tepër, takimet nuk mbahen çdo tre muaj, siç përcaktohet me rregullore. Sipas diskutimeve me DKA-në në Obiliq, është raportuar se këto ekipe dorëzojnë raporte vetëm një herë në vit, me arsyetimin se nuk ka raste të braktisjes. E njëjta gjë ndodh edhe me EPRBM-në në nivel komunal, e cila gjithashtu nuk organizon takime çdo tre muaj. Aktualisht, nuk ka fonde të ndara për EPRBM-të në Obiliq, dhe mungon një Plan Komunal i Veprimit për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit në shkolla. Ky plan ka filluar draftimin në vitin e kaluar.

Neni 15 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar përcakton se komunat janë të detyruara të sigurojnë transport për nxënësit e arsimit të detyrueshëm, veçanërisht ata që jetojnë mbi katër kilometra larg shkollës.* Në Komunën e Obiliqit, kjo zbatohet plotësisht, me sigurimin e transportit fizik ose kompensimin financiar në rastet kur nxënësit jetojnë në distancë mbi katër kilometra edhe për nxënësit në arsimin e mesëm.

Sipas Udhëzimit Administrativ 04/2013 për ndihmën sociale, certifikatat shkollore për fëmijët 6-18 vjeç janë të nevojshme për aplikimin dhe vazhdimin e përfitimeve nga ndihma sociale.*

*Kushtetuta, neni 22: Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

*Udhëzimi Administrativ 08/2018, Për krijimin dhe forcimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar.

*Ligji Nr. 04/L-32 për Arsimin parauniversitar në Kosovë, neni 15.5.

*Udhëzimi Administrativ 04/2013 për parashtrimin e kërkesave dhe procedurat për ndihmë sociale, Neni 5

Përveç ligjeve dhe akteve nënligjore, Strategjia e Arsimit e Kosovës 2022-2026 dhe Strategjia për Avancimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Kosovë 2022-2026 adresojnë problemin e braktisjes së shkollës. Strategjia e Arsimit synon të rrisë përfshirjen dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve nga grupet e marginalizuara, duke ulur nivelin e braktisjes së shkollës në arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm të lartë. Strategjia për Rom dhe Ashkali vendos si objektivë rritjen e mundësive për qasje të barabartë në arsim cilësor gjithëpërfshirës për këto komunitete.

Pavarësisht kornizës së fuqishme ligjore, sfidat në funksionalizimin e plotë të EPRBM-ve dhe zbatimin e strategjive mbeten të pranishme. Sipas vlerësimeve të ndryshme, mekanizmat e krijuar për parandalimin e braktisjes funksionojnë pjesërisht, duke ndikuar në vazhdimësinë e fenomenit të braktisjes së shkollës nga komunitetet joshumicë.*

Faktorët e rrezikut për braktisje të shkollës

Faktorët e rrezikut për mos-regjistrim, mos-vijim dhe braktisje të shkollës në Komunën e Obiliqit janë të ngjashme me ato të komunave të tjera. Këta faktorë përfshijnë distancën fizike nga shkollat, mungesën e transportit ose transportin e papërballueshëm, shqetësimet e sigurisë së përgjithshme dhe personale (si qentë endacakë dhe mungesa e trotuareve), martesat e hershme, kostot e larta të arsimit, detyrimet familjare, çështjet shëndetësore, vendimet e prindërve, ndjenja e mospërshtatjes për shkak të moshës më të madhe se shokët e klasës dhe mungesa e motivimit.* Gjithashtu, emigracioni, punësimi i hershëm, puna sezonale – veçanërisht për meshkujt në gastronomi – dhe mungesat e larta që shpesh çojnë në braktisje, mbeten sfida të rëndësishme.

Pjesëmarrja e nxënësve sipas komunitetit

Nga analiza e tabelave të dhëna për arsimin fillor dhe atë të mesëm në komunën e Obiliqit, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë, në ASK janë marrë këto të dhëna ku vërehen disa ndryshime në pjesëmarrjen e komuniteteve në dy nivelet arsimore.*

Pjesëmarrja e nxënësve shqiptarë:

- **Arsimi fillor:** Numri i nxënësve shqiptarë ka pësuar rënie gjatë viteve, nga 3,225 në vitin 2015/2016 në 2,632 në vitin 2023/2024.
- **Arsimi i mesëm:** Në arsimin e mesëm, numri i nxënësve shqiptarë është dukshëm më i ulët sesa në fillor, duke rënë nga 649 në vitin 2015/2016 në 613 në vitin 2023/2024. Kjo tregon se një pjesë e nxënësve shqiptarë nuk vazhdojnë arsimin e mesëm ose mund të kalojnë në shkolla jashtë Obiliqit.

*KOSINT 2020, Raporti i vlerësimit të efektivitetit të EPRBM-ve, Raporti i fokusuar në efektivitetin e EPRBM-ve në për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, gusht, 2019.

*UNICEF, MICS, 2019-2020 MICS në Kosovë & 2019-2020 MICS me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë)

*Agjencia e Statistikave të Kosovës, numri i nxënësve në arsimin fillor-të mesëm të ulët sipas përkatësisë etnike, 2015/16-2023/24 dhe numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë sipas përkatësisë etnike, 2015/2016-2023/2024

Pjesëmarrja e nxënësve ashkali:

- **Arsimi fillor:** Numri i nxënësve të komunitetit Ashkali ka një rritje graduale, nga 89 në vitin 2015/2016 në 172 në 2023/2024.
- **Arsimi i mesëm:** Në krahasim me filloren, shumë më pak nxënës të komunitetit Ashkali vazhdojnë arsimin e mesëm. Për shembull, në 2023/2024 ka vetëm 4 nxënës Ashkali në shkollat e mesme të Obiliqit.

Ka një braktisje të madhe nga ky komunitet në kalimin nga arsimi fillor në të mesëm.

Pjesëmarrja e nxënësve rom:

- **Arsimi fillor:** Numri i nxënësve romë është rritur nga 1 në vitin 2016/2017 në 6 në vitin 2023/2024.
- **Arsimi i mesëm:** Pjesëmarrja e romëve është shumë e ulët, por ka pasur raste të regjistrimit, me 5-7 nxënës në disa vite.

Pjesëmarrja e nxënësve turq, boshnjakëve, egjiptianëve dhe të tjerëve:

- **Arsimi fillor:** Ka shumë pak përfaqësues nga këto komunitete, me raste të izoluara si 149 turq në vitin 2018/2019.
- **Arsimi i mesëm:** Pjesëmarrja e këtyre komuniteteve është pothuajse zero, duke treguar mungesë vijueshmërie ose ndoshta orientim drejt shkollave të tjera.

Braktisja më e madhe ndodh nga arsimi fillor në të mesëm, veçanërisht te komunitetet joshqiptare si Ashkalinjtë dhe Romët. Numri i përgjithshëm i nxënësve po bie në të dyja nivelet, duke reflektuar trende demografike dhe sfida sociale.

Këto të dhëna tregojnë qartë për sfida të vazhdueshme me të cilat përballen komunitetet ashkali dhe rom, si mungesa e mbështetjes sociale, ekonomike dhe pedagogjike, si dhe nevoja për ndërhyrje më të strukturuar.

Si mund të bëhet indentifikimi i fëmijëve jashtë shkolle?

Fëmijët jashtë shkolle mund të identifikohen nga një sërë institucionesh, mekanizmash dhe profesionistësh, të cilët kanë përgjegjësi për monitorimin dhe mbështetjen e arsimit. Në këtë proces, një rol të rëndësishëm luajnë:

- Ekipi për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes së Mësimit (EPRBM) në nivel shkolle, i cili fokusohet në identifikimin e fëmijëve që janë në rrezik për të braktisur shkollën, atyre që e kanë braktisur.
- Mësimdhënësit dhe drejtuesit e shkollave, të cilët kanë kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit dhe mund të vërejnë mungesat e vazhdueshme apo problemet që çojnë në braktisje.
- Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), të cilat kanë detyrë të mbledhin të dhëna mbi regjistrimin dhe vijueshmërinë e nxënësve dhe të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse për trajtimin e rasteve.
- Shërbimet sociale dhe institucionet e mbrojtjes së fëmijëve, të cilat mund të identifikojnë fëmijët jashtë shkolle gjatë punës së tyre me familjet në nevojë.
- Organizatat joqeveritare dhe komuniteti, përmes projekteve dhe iniciativave për mbështetjen e arsimit dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Familjet dhe qytetarët, të cilët mund të raportojnë raste të fëmijëve që nuk ndjekin shkollën ose që rrezikojnë ta braktisin atë.

Përmbledhje e mekanizmave për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit

- Mentorimi dhe mbështetja psiko-sociale: Përdorimi i mentorëve, përfshirë edhe mentorimin nga bashkëmoshatarët, mund të ndihmojë nxënësit që janë në periudha të pasigurisë, si kalimi në shkollë të reja. Mentorët mund të ofrojnë mbështetje emocionale dhe të ndihmojnë në integrimin social të nxënësve të rinj.
- Mbështetje në mësim dhe orët plotësuese: Nxënësit që hasin vështirësi në mësim mund të ndihmohen përmes orëve plotësuese ose mbështetjes individuale për të siguruar që ata të përmirësohen dhe të qëndrojnë të angazhuar në shkollë.
- Tekstet shkollore falas: Tekstet shkollore janë ofruar falas për të gjithë nxënësit që nga viti 2015, duke krijuar mundësi më të barabarta për arsim. Megjithatë, ndryshimi në qasje në shpërndarjen e librave shkollorë në vitin 2023, duke ofruar pagesa për prindërit për blerjen e teksteve përmes platformës e-Kosova, ka prekur negativisht disa komunitete më të cenueshme për shkak të barrierave teknologjike dhe mungesës së librave në disa zona.
- Arsimi jo-formal dhe mbështetje për fëmijët e riatdhesuar: Shkollat mund të ofrojnë mundësi për fëmijët që nuk kanë pasur mundësi të regjistrohen në shkollë më herët, duke siguruar kurse të gjuhës dhe aktivitete të tjera për të integruar ata në mësim.
- Kontrolli dhe komunikimi ndër-shkollor: Shkollat duhet të bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar se nxënësit që transferohen nga një shkollë në tjetrën janë të regjistruar dhe vijnë në mësimin pa ndërprerje.
- Orientimi në karrierë Sigurimi i mundësive për udhëzim në karrierë mund të motivoni nxënësit për të vazhduar arsimin e tyre dhe të marrin vendime të informuara për të ardhmen e tyre profesionale.

Rekomandime




Rekomandime për drejtoritë komunale të arsimit

- Të integrohen në Planet Lokale të Veprimit masat për zbatimin e Strategjisë për Avancimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian.
- Të sigurohet që të dhënat për braktisjen të ndahen sipas komunitetit, gjinisë dhe klasës, për të orientuar ndërhyrjet parandaluese.
- Organizimi i trajnimeve për stafin shkollor mbi përdorimin e SMIA për gjurmimin e vijueshmërisë dhe identifikimin e hershëm të rrezikut.
- Të ofrohet mbështetje për EPRBM-të në nivel shkollor dhe komunal, duke monitoruar takimet dhe raportet e tyre.
- Të identifikohen shkollat me përqindje të lartë braktisjeje dhe të zhvillohen plane veprimi specifike për to.
- Të mbështeten OJQ-të që zhvillojnë aktivitete për reduktimin e braktisjes dhe ofrojnë mbështetje për nxënësit me vështirësi.
- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjëse me fokus në komunitetet e cënueshme.
- Të ndahen fonde për mësim plotësues për nxënësit që kanë filluar me vonesë ose që kanë munguar gjatë procesit mësimor.

Rekomandime për shkollat

- Të monitorohet rregullisht vijueshmëria e nxënësve dhe të përdoret SMIA për të identifikuar mungesat e përsëritura dhe rrezikun e braktisjes.
- Të zbatohen programe të veçanta për identifikimin e nxënësve në rrezik përmes vlerësimeve të rregullta të performancës dhe sjelljes së tyre.
- Të krijohen plane mësimore të personalizuara për nxënësit me sfida, duke përfshirë këshillime dhe mentorim të dedikuar.
- Të ndërtohet një ambient shkollor ku nxënësit të ndihen të përfshirë dhe të respektuar, pavarësisht prejardhjes.
- Të organizohen takime të rregullta me prindërit dhe të krijohen mundësi bashkëpunimi për të trajtuar sfidat dhe për të motivuar fëmijët.
- Të organizohen aktivitete për të vlerësuar arritjet e nxënësve, si akademike ashtu edhe ato jashtëshkollore, për të rritur motivimin për mësim.

Si përfundim, vërejmë se të dhënat tregojnë një rënie të konsiderueshme të pjesëmarrjes së nxënësve në arsimin e mesëm krahasuar me arsimin fillor, veçanërisht te komunitetet joshqiptare. Komunitetet e tjera etnike kanë pjesëmarrje minimale ose mungesë të plotë në arsimin e mesëm, duke ngritur shqetësime për përfshirjen dhe barazinë në arsim. Kjo situatë nënvizon nevojën për masa konkrete mbështetëse, si ndihma financiare, programe motivuese dhe këshillim arsimor, për të siguruar vijueshmëri më të lartë dhe mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit.



Prishtinë, 2025